

Procesverbal
Mbledhja e radhës së Këshillit Bashkiak Skrapar
Mbajtur më datë 28.01.2026

Ora e hapjes së mbledhjes sipas njoftimit 10:00, vendi i mbajtjes së mbledhjes : Salla e mbledhjeve e Këshillit Bashkiak Skrapar, Qendra Kulturore “Riza Cerova” Kati i Dytë.

Listëprezenca e Këshilltarëve pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes.

1. ALMA KADIASI
2. ARJAN HASA
3. ALBANA HOXHA m
4. EDMOND KALEMI
5. ELSA PETRITAJ
6. ERAJD ZAIMI m
7. ENVER ÇAKA
8. FIKRET TELHA
9. LIRI NUHELLARI
10. MIMOZA HYSAJ m
11. MIMOZA ZYLYFTARI
12. MYQERRET HEBIBASI
13. PËLLUMB GURI
14. SKERDILAJT JAUPLLARI
15. VALBONA GROPA

Sekretare e Këshillit deklaroi kuorumin prej 12 Këshilltarësh.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Kryetari i Bashkisë z. Adriatik Mema, përfaqësues të administratës, të cilët kanë hartuar projekt-vendimet që do të merren në shqyrtim

Kryetare Këshillit deklaroi hapjen e mbledhjes duke kaluar në pikën 1, miratimi i rendit të ditës sipas njoftimit të bërë me nr. 03 prot. të datës 22.01.2026.

Kryetare e Këshillit kërkoi nga anëtarët e këshillit mirëkuptimin për të futur në rendin e ditës një projekt-vendim shtesë “Për dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasin Fatos Myftari” drejtoi pyetjen nëse ka pyetje, diskutime propozime në lidhje me rendin e ditës.

Këshilltarët shprehin dakortësi me rendin e ditës të njoftuar.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës sipas njoftimit.
Ora 10:00

Vota pro: 11, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Liri Nuhellari, Mimoza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s’ka

Vota ABSTENIM: s’ka

Pika 2 e rendit të ditës , Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Konstituimit të Këshillit Bashkiak, datë 22.12.2025 dhe 09.01.2026.

Kryetare Këshillit u drejtoi pyetjen këshilltarëve nëse ka dikush për të shtuar diçka në lidhje me procesverbalin i cili u është vënë në dispozicion çdo këshilltari së bashku me materialet e mbledhjes së radhës.

Këshilltarët shprehin dakortësi .

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mëparshme . Ora 10:10

Vota pro: 11,Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Liri Nuhellari, Mimoza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s’ka

Vota ABSTENIM: s’ka

Pika 3 deklarimet e konfliktit të interesave

Kryetare Këshillit drejton pyetjen në se ka konflikt interesi nga këshilltarët për çështjet që do të merren në shqyrtim.

Për çështjet që do të merren në shqyrtim asnjë nga anëtarët e këshillit nuk ka shprehur konflikt interesi.

Pika 4 e rendit të ditës “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e Bashkisë Skrapar për muajin Dhjetor 2025”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z. Pëllumb Guri i cili shpreh se janë futur me fondet e bashkisë.

Me leje fjalën e merr z. Arjan Hasa i cili pyet nëse i kanë marrë që nga muaji shtator? Është një zotëri që nuk i ka marrë lekët që nga muaji shtator. Fetahu është në listë?

Fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila shpreh se janë me fondet e bashkisë dhe se lekët i kanë marrë çdo muaji. Për personin që shpreh se nuk i ka marrë lekët do parë arsyeja pse nuk i ka marrë. Fetahu është e ke në relacion edhe muajt e tjerë i ka marrë dhe një muaji që ne e dogjëm i ka marrë nga fondet e bashkisë ja ka çuar postieri.

Kryetare e Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:20

Vota pro: 11, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Liri Nuhellari, Mimoza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s`ka

Vota ABSTENIM: s`ka

Pika 5 e rendit të ditës “Mbi dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasen Alma Shkëmbi”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes? jo

Kryetare e Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:25

Vota pro: 11, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Liri Nuhellari, Mimoza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s`ka

Vota ABSTENIM: s`ka

Pika 6 e rendit të ditës “Mbi dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasen Hëna Hasanaj”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes? jo

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:30

Vota pro: 11, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Liri Nuhellari, Mimoza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 7 e rendit të ditës “Mbi dhënien e ndihmës financiare nga Bashkia Skrapar për shtetasin Fatos Myftari”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes? jo

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:35

Vota pro: 11, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Liri Nuhellari, Mimoza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 8 e rendit të ditës “Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr znj. Teuta Hysenbelliu e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z.Pëllumb Guri i cili shpreh se çfarë duhet të kenë këto familje dhe se duhet tju shpjegohet mirë që mos të digjen.

Fjalën e merr znj.Teuta Hysenbelliu e cila shpjegon se mbi bazën e këtyre kritereve unë rekomandoj familjet që të trajtohen me fondin e kushtëzuar 6%. Jo çdo familje mund të trajtohet me fondin e kushtëzuar, se mund të kemi një familje që nuk ka marrë pikët e mjaftueshme kjo për arsye se është në gjendje sociale ekonomike shumë të mira. Familjet që trajtohen janë në bazë të kritereve që janë shënuar në relacion.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:45

Vota pro: 11, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Liri Nuhellari, Mimoza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 9 e rendit të ditës “Për miratimin e kalendarit të hartimit të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029, për Bashkinë Skrapar dhe institucioneve të varësisë”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr z.Neim Gogo i cili prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes? jo

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 10:50

Vota pro: 11, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Liri Nuhellari, Mimoza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 10 e rendit të ditës “Për detajimin e fondeve të investimeve të trashëguara nga viti 2025”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr z.Neim Gogo i cili prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z.Pëllumb Guri i cili pyet nëse fondet që nuk u përdorën nga këshilli mund të trashëgohen?

Fjalën e merr z.Neim Gogo i cili shpreh se ato trashëgohen dhe përdoren për vitin aktual buxhetor, por akoma nuk i kemi bërë sepse nuk kanë të bëjnë me investimet janë shpenzime operative.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili pyet se si trashëgohen, dhe a është e njëjta vlerë që ka qenë?

Fjalën e merr z.Neim Gogo i cili shpreh se në momentin që nuk përdoren ato trashëgohen. Ju duhet ti shpenzoni ato që planifikohen në vitin buxhetor. Ato ngelen si fonde të papërdorura por ato shpërndahen si të trashëguara dhe përfshihen te buxheti aktual i këtij viti. Edhe ne kemi shpenzime operative që i kemi kursyer nga menaxhimi i mirë ose janë bërë tendera dhe ne i kemi kapur me vlera më të vogla ato shpenzimet dhe na kanë ngelur ca lekë, nuk i lëmë prap aty është ndryshe me shpenzime operative ndryshe me investimet, investimeve nuk ua ndryshon dot destinacionin kurse shpenzimet i çon ku ka nevojë. Unë themë që për vitin 2026 ju keni planin e shpenzimeve sipas atij plani bëni programin e aktiviteteve ku do shkoni trajnime, vizita edhe kundrejt faturave tuaja ne bëjmë financimin.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 11:00

Vota pro: 12, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Zylyftari, Myqerret hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 11 e rendit të ditës “Për detajimin e grantit të performancës akorduar për vitin 2025 në zbatim të udhëzimit nr.1031/5, datë 11.07.2025”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr z.Neim Gogo i cili prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z.Fikret Telha i cili shpreh se do të ishte më shumë dakort sa më pak shpenzime për kopjuterat dhe printerat se çdo vit janë blerë.

Fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z. Adriatik Mema i cili shpreh se janë marë dhurate dhe kanë qenë të përdorur. Ne nuk kemi një fotokopje me ngjyra, apo një printer që të mund të fotokopjojë një material me sasi të konsiderueshme.

Fjalën e merr z.Neim Gogo i cili shpreh se afati i përdorimit të çdo kompjuteri, printeri është 4-5 vjet. Ky lloj granti performancës zakonisht përdoret për blerjen e paisjeve që të performoj administrata mirë se po nuk pati mjetet e duhura nuk performojmë mirë.

Me leje fjalën e merr z.Pëllumb Guri i cili shpreh se çfarë do bëhet me këshillin ndonjë një tabletë ndonjë lehtësim për mos harxhuar aq shumë letra. E kam ngritur zërin shumë herë dhe nuk është bërë asgjë.

Fjalën e merr z.Neim Gogo i cili shpreh se duhet të bëni kërkesën.

Fjalën e merr Kryetare Këshillit znj.Elsa Petritaj e cila shpreh se kërkesa është bërë për laptopa por Kryetari tha që ka shumë shpenzime dhe e lamë, kurse për mikrofonta, kamera është bërë kërkesa.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 11:10

Vota pro: 12, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 12 e rendit të ditës “Për detajimin e transfertës akorduar me aktin normativ nr.11, datë 19.12.2025”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr z.Neim Gogo i cili prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z.Fikret Telha i cili shpreh se nëqoftëse nuk do ta miratonte qeveria këtë fond si do e përballonit? Të ardhurat pse nuk realizohen? Sa % vini tek realizimi të ardhurave?

Fjalën e merr z. Neim Gogo i cili shpreh se realizohet 86% .

Me leje fjalën e merr z.Fikret Telha i cili shpreh se pse nuk realizohet i gjithë plani?

Fjalën e merr z. Neim Gogo i cili shpreh se ne kemi planifikuar të ardhura nga fondit pyjor me 33 milion lekë të reja për vendosjen e paneleve për park fotovoltai me një kompani e cila nuk është paraqitur për të vazhduar procedurën ka ngelur e paralizuar. Dhe 10 milion lekë të reja të porealizuara janë taksë toke dhe taksë ndërtesë për të gjitha familjet ktu në qytet dhe në fshatë që janë larguar nga territori bashkisë. Diferenca aty është jo se ne nuk punojmë për të realizuar të ardhurat.

Me leje fjalën e merr z.Fikret Telha i cili pyet se sa i realizojnë njësitë këto të ardhura? Se ju edhe i keni stimuluar ca administratorë marin më shumë disa më pakë.

Fjalën e merr z. Neim Gogo i cili shpreh se njësitë janë ato që nuk harrijnë dot të mbledhin të ardhura, dhe unë të japë të drejtë sepse shpenzimet për paga dhe sigurime janë 5 fish krahsuar me atë çka sjellin njësitë.

Fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z. Adriatik Mema i cili shpreh se ajo diferencë është e papërfillshme.

Me leje fjalën e merr z. Fikret Telha i cili shpreh se po të ishte e papërfillshme i lije të gjithë njësojë. Unë them se është në bazë të performancës. Për mua me njësitë administartive keni dështuar.

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 11:25

Vota pro: 12, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 13 e rendit të ditës “Për detajimin e të ardhurave të realizuar në muajin Dhjetor 2025”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr z. Neim Gogo i cili prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes? jo

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 11:30

Vota pro: 12, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 14 e rendit të ditës “Për miratimin në parim të bashkëfinancimit në masën 20% në programin e përmirësimit të banesave ekzistuese”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr znj. Rudina Llango e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes? jo

Kryetare e Këshillit deklaroi hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 11:40

Vota pro: 12, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Pika 15 e rendit të ditës “Për miratimin në parim të listës emërore të familjeve që përfitojnë nga programi i përmirësimit të kushteve të banesave ekzistuese”.

Kryetare Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit

Me leje fjalën e merr znj.Rudina Llango e cila prezantoi projektvendimin sipas relacionit bashkëlidhur.

Kryetare Këshillit drejton pyetjen nëse ka pyetje diskutime rreth çështjes?

Me leje fjalën e merr z.Fikret Telha i cili shpreh pse kjo listë emrash? Pse mos të vinin të tërë emrat dhe të vendoste këshilli. Pse duhet ti jepet Mbaseses kur i është dhënë një herë dhe si ka shpenzuar si duhet, mund ti jepet dikujt tjetër që ka vërtet nevojë.

Me leje fjalën e merr znj.Liri Nuhellari e cila shpreh se znj.Mbaresa Hamzollari i është dhënë dhe është treguar e papërgjegjshme pse duhet ti jepet përsëri.

Fjalën e merr znj Rudina Llango e cila shpjegon se ky është një miratim në parim i listës sepse qytetarët kanë që duke plotësuar dokumentacionin dhe ne kemi qenë në terren për të verifikuar. Vetë qytetarët kanë treguar interes për këto banesa duke paraqitur edhe kërkesa. Për sa i përket znj.Mbaresa nuk mund të bëjë dot gjë sepse do punoj firma që do fitoj prokurimin se nuk do tu jepen lekë në dorë ktyre familjeve.

Fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema i cili sqaron se kjo procedurë ka qenë e përshpejtuar për shkak se jemi orjentuar vonë për ta bërë këtë aplikim, shumë bashki të tjera e kanë përfituar, ne e kemi për herë të parë këtë aplikim dhe nuk e dimë nëse mund ta fitojmë apo jo, për shkak se ne na mungon një plan strehimi që është një nga kriteret kryesore. Por duke qenë se në këtë periudhë harritëm të identifikojmë me grupe në terren këto familje të cilat edhe këto që janë në listë që ju janë paraqitur sot ju për miratim ende nuk e kanë plotësuar dokumentacionin. Nëqoftëse të interesuarit nuk depozitojnë në bashki certifikatën e pronësisë për banesën automatikisht nuk do të jenë pjesë e kësaj liste. Është i vërtë rasti i znj. Mbaresa Hamzollarit që janë shpërdoruar ndihma që i është dhënë nga fondi emergjencave civil, kështu që ju takon juve të vendosni, mund edhe të hiqet por siç u shpjegua nuk bëhet fjalë të jepen lekë të transferuara por do punoj vetë firma.

Me leje fjalën e merr z.Arjan Hasa i cili shpreh padakortësi se nuk është dakort me znj.Rudinë që thotë kemi bërë studim në terren, ka persona që janë në gjendje shumë të keqe me 4 fëmijë, pa asnjë lekë shtëpinë në trra. Nuk është bërë studimi rregullt ka dhe nëpër fshatrra plotë.

Fjalën e merr znj.Rudina Llango e cila shpjegon se bashkia nuk bëri studimin në terren, bëri studimin e atyre familjeve që shprehën interes.

Fjalën e merr Kryetari i Bashkisë z.Adriatik Mema i cili shpjegon se për familjen që z.Arjan Hasa shpreh shqetësim i është dhënë ndihmë në një mënyrë tjetër.

Fjalën e merr znj Rudina Llango e cila shpreh nëse miratohen këto projekte dhe nëse ne do të fitojmë këto projekte pranë Ministrisë atëherë e kemi rrugën e hapur për të aplikuar dhe në vitet e ardhshme për programe të tjera të sterhimit jo të kësaj kategorie por të një kategorie tjetër për përfitimim e banesave me qira sociale. E mira është ne të fitojmë këtë program që është më emergjente sot.

Me leje fjalën e merr z.Fikret Telha i cili shpreh nëse kanë bërë ndonjë foto këta që kanë bërë studimin se mos ndoshta ka më shumë familje?

Fjalën e merr znj Rudina Llango e cila shpreh se ne kemi shkuar tek ato familje që kanë shprehur interes.

Kryetare e Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e projektvendimit. Ora 12:00

Vota pro: 12, Alma Kadiasi, Arjan Hasa, Edmond Kalemi, Elsa Petritaj, Enver Caka, Fikret Telha, Liri Nuhellari, Mimoza Zylyftari, Myqerret Hebibasi, Pëllumb Guri, Skerdilajt Jaupllari, Valbona Gropa.

Vota KUNDËR: s'ka

Vota ABSTENIM: s'ka

Të ndryshme

Fjalën e merr z.Fikret Telha i cili shpreh disa shqetësime lidhur me disa problematika në qytet:

- Të merren masa për rregullimin e urës pranë shkollës "Ramiz Aranitasi".
- Të sigurohen dhe funksionalizohen pajisjet e ngrohjes në shkollën "Ramiz Aranitasi".
- Të ndërhyhet për riparimin e asfaltit në lagjen "5 Shtatori", i cili është dëmtuar.
- Për mbiellje pemësh për gjelbërim të qytetit .

Kryetare e Këshillit e deklaron përfundimin e mbledhjes .

Sekretare Këshillit Bashkiak: Xheni Çela

Kryetare Këshillit Bashkiak:

Këshilltarët që firmosin procesverbalin:

1.Alma Kadiasi

2.Fikret Telha

3.Skerdilajt Jaupllari

Elsa Petritaj